

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA” FAKULTETI JURIDIK

Niveli: Master

Programi: Financiar

Mentor: Prof.Dr.Bedri PEÇI

Kandidat: Dafina VLAHNA

ABSTRAKT

Shteti i Kosovës që nga themelimi si shtet Juridik, formuloi rregulla për funksionimin dhe zhvillimin sa më të mirë dhe atë me theks të veçantë në sektorin e Ekonomisë. Jo rastësisht theksi i veçantë i vihet sektorit të Ekonomisë, pasi që nëse kemi ekonomi të zhvilluar mirë kemi dhe shtet të zhvilluar. Para se gjithash Ekonomia është pasqyra më e mirë e një shteti, dhe atë përmes së cilës vërehet se sa kapacitet financiar ka një shtet ashtu dhe se sa është i zhvilluar sektori i punësimit. Duke marrë parasysh se Ekonomia është po baza e themelimit të shtetit të qëndrueshëm dhe funksional, atëherë janë marrë strategji se si të zhvillojmë ekonominë dhe atë duke analizuar me theks të veçantë në të hyrat publike në bazë të së cilave përcaktohet buxheti i shtetit, e ndër të cilat janë: taksat, kontributet, doganat e në veçanti dhe huat publike me të cilat në shumicën e rasteve shteti i përballon krizat financiare që mund ti ndodhin nga shpenzimet e pa pritura.

Nga kjo kuptohet që duhet të bëhet financimi i mirë publik, i cili arrihet nga menaxhimi i mirë i të hyrave publike, e në rast të veçantë kur kemi të bëjmë me huat publike, të cilat shteti që marrë hua publike duhet të bëjë dhe menaxhimin sa më të mirë të tyre.

Bazuar në menaxhimin e mirë të huas publike, shteti mund të arrij rimëkëmbje dhe zhvillim në ekonominë e vendit, pasi që përmes huas së marrë ka investuar në vendet apo institucione të nevojshme, e po ashtu ato hua i kthen subjekteve në kohën e përcaktuar në kontratë, përndryshe në raste të kundërta ai shtet mund të vijë deri tek rrënja në borxh si dhe falimentimi i shtetit si subjekt juridik.

Andaj, që të mos ketë probleme si ai i kolapsit të shtetit, i cili mund të vijë nga keqmenaxhim i huave publike, atëherë duhet ndërmarr mekanizma paraprak që të bëhet një menaxhim sa më i mirë i huave publike, e po ashtu dhe menaxhimi i kthimit në kohë i huas së marrë. Për huan publike, dhe menaxhimin e mirë të huas publike në përgjithësi, dhe në veçanti në shtetin e Kosovës flitet më gjerësisht në përmbajtjen e këtij punimi të studimeve të masterit.

Fjalët kyçe: Të hyrat publike, huat publike, menaxhimi i huave publike, kthimi i huave.